

Shkurt. Qartë.
Informacion
për prindërit

Bebe + fëmijë të vegjël 0-3 vjeç

Rritja në një mjedis shumëgjuhësor*

Mehrsprachig aufwachsen*

* A dinit që fëmijët mund të mësojnë disa gjuhë në mënyrë të natyrshme?

* Wussten Sie, dass Kinder natürlich mehrere Sprachen lernen können?



A dini që....

Wussten Sie ...

...fëmijët mund të mësojnë disa gjuhë në një mënyrë plotësisht të natyrshme? Fëmijët mund të mësojnë disa gjuhë në të njëjtën kohë ose të mësojnë më parë një gjuhë dhe pastaj një gjuhë tjetër. Sipas mendimit të specialistëve, ky është një talent i natyrshëm i njeriut.

... dass Kinder ganz natürlich mehrere Sprachen lernen können? Kinder können gut mehrere Sprachen gleichzeitig wie auch erst eine und dann eine andere Sprache lernen. Fachleuten zufolge ist dies eine natürliche Begabung des Menschen.

...çdo herë e më shumë fëmijët rriten në një mjedis dygjuhësor ose shumëgjuhësor? Në shumë shtete fëmijët rriten në mjedise, ku flitet më shumë se një gjuhë. Në Gjermani dygjuhësia është shumë e shpërndarë. Në shumicën e rasteve gjermanishtja është gjuha e dytë.

... dass immer mehr Kinder zwei- oder mehrsprachig aufwachsen? In vielen Ländern wachsen Kinder mit mehr als einer Sprache auf. Auch in Deutschland ist Zweisprachigkeit weit verbreitet. In den meisten Fällen ist Deutsch dann die Zweitsprache.

...sa më shpejtë fëmijët fillojnë të mësojnë një gjuhë aq më lehtë do ta përvetësojnë? Në vitet e para të jetës, fëmijët mund të mësojnë një gjuhë tjetër pothuajse me të njëjtën lehtësi me të cilën e kanë mësuar gjuhën amtare.

... dass Kinder eine Sprache umso leichter lernen, je früher sie damit beginnen? In den ersten Lebensjahren können Kinder eine Zweitsprache fast genauso leicht lernen wie ihre Muttersprache.

...rritja në një mjedis shumëgjuhësor i ofron fëmijës mundësi të mëdha? Shumë thjesht. Fëmija nuk do të ketë më vonë mundësi të mësojë një gjuhë tjetër aq lehtë. Shumëgjuhësia do t'i ofrojë përparësi të mëdha në të ardhmen.

... dass mehrsprachig aufzuwachsen einem Kind eine große Chance bietet? So einfach wird ein Kind verschiedene Sprachen nie wieder lernen. Im späteren Leben kann ihm seine Mehrsprachigkeit große Vorteile bieten.

...që përkushtimi, gëzimi i komunikimit dhe inkurajimi i mjaftueshëm në të dyja gjuhët janë baza më e mirë për një zhvillim shumëgjuhësor të suksesshëm?

... dass Zuwendung, Sprechfreude und genügend sprachliche Anregungen in beiden Sprachen die beste Grundlage für eine erfolgreiche mehrsprachige Entwicklung sind?





Më shumë informacion lidhur me zhvillimin e fëmijëve dhe dygjuhësinë mund të gjeni në faqen web

Mehr zur kindlichen Sprachentwicklung und zur Mehrsprachigkeit unter

www.kindergesundheit-info.de

Për prindërit/Zhvillimi i fëmijëve: Nga foshnja e gjirit deri në fëmijën e vogël: viti i parë i jetës

Për prindërit/Zhvillimi i fëmijëve: Fushat dhe hapat e zhvillimit

Edhe pediatri juaj mund t'u përgjigjet pyetjeve tuaja.

Për etapat më të rëndësishme të mësimit të së folurës dhe për mënyrën se si ju mund ta mbështetni fëmijën tuaj, ju mund të lexoni në seksionin **SHKURT.QARTË.-INFORMACION PËR PRINDËRIT** "Fjala e parë" dhe "Mësimi i së folurës".

www.kindergesundheit-info.de

Für Eltern/Die kindliche Entwicklung:

Vom Säugling zum Kleinkind: Das 1. Lebensjahr

Für Eltern/Die kindliche Entwicklung:

Entwicklungsbereiche und Entwicklungsschritte

Fragen beantwortet auch gern Ihr Kinderarzt oder Ihre Kinderärztin.

Die wichtigsten Etappen beim Sprechenlernen und wie Sie Ihr Kind dabei unterstützen können, lesen Sie in den **KURZ.KNAPP.-ELTERNINFOS** „Das erste Wort“ und „Sprechen lernen“.

Ju duhet të dini

Kur fëmijët mësojnë disa gjuhë njëkohësisht, zhvillimi i tij gjuhësor mund të jetë më pak "i renditur" (për shembull, një fond fjalësh më të vogël, struktura më të thjeshta të fjalive). Këto "turbullime" janë normale dhe zakonisht zhduken pas ca kohe.

Konsultoni pediatri domosdo, nëse shikoni që fëmija juaj flet ose kupton shumë më pak sesa moshatarët e tij ose nëse shqiptimi i tij është i pakuptueshëm.



Gut zu wissen

Vor allem, wenn ein Kind verschiedene Sprachen gleichzeitig lernt, kann die Sprachentwicklung bis ins frühe Schulalter auch etwas weniger „ausgefeilt“ sein (z. B. kleinerer Wortschatz oder einfacherer Satzbau). Solche „Auffälligkeiten“ sind normal und geben sich in der Regel nach einer Weile von allein.

Wenden Sie sich unbedingt an Ihren Kinderarzt oder Ihre Kinderärztin, wenn Sie den Eindruck haben, dass Ihr Kind deutlich weniger als Gleichaltrige spricht und versteht oder seine Aussprache nur schwer verständlich ist.

Mbështetja për zhvillimin shumëgjuhësor të fëmijës

Die mehrsprachige Entwicklung unterstützen

5 këshilla të rëndësishme | Die 5 wichtigsten Tipps

1 Bisedoni me fëmijën në gjuhën tuaj amtare.

Nëse jeni nënë ose baba, flisni me fëmijën në gjuhën, me të cilën ju mund ta qetësoni, ta ngushëlloni dhe t'i tregoni dashuri më së miri. Kjo gjuhë është gjithmonë gjuha juaj amtare.

Sprechen Sie in Ihrer eigenen Muttersprache mit Ihrem Kind. Sprechen Sie als Mutter oder Vater immer in der Sprache mit Ihrem Kind, in der Sie es am besten beruhigen, trösten und ihm Ihre Zuneigung zeigen können. In der Regel ist dies die eigene Muttersprache.

2 Në rast dygjuhësie, përcaktoni "rregulla të qarta të komunikimit" në familje.

Mos ndërroni gjuhën pa arsye dhe mos përdorni gjuhë të ndryshme në mënyrë arbitrare. Është e rëndësishme që fëmija të di që secila gjuhë përdoret në situata të përcaktuara dhe me persona të ndryshëm. p.sh. turqishtja me nënën dhe gjermanishtja me babanë.

Schaffen Sie bei Zweisprachigkeit innerhalb der Familie klare „Sprachregeln“. Wechseln und benutzen Sie die Sprachen in der Familie nicht willkürlich: Für Ihr Kind ist es wichtig, dass es eine bestimmte Sprache mit bestimmten Situationen oder mit einer bestimmten Person in Verbindung bringen kann, z.B. Türkisch mit der Mutter, Deutsch mit dem Vater.

3 Që nga fillimi, përkëdhelni fëmijën në gjuhën tuaj amtare.

Duke i ofruar kënaqësinë e komunikimit dhe një material gjuhësor të mirë, do të nxitni zhvillimin e fëmijës në gjuhën amtare. Në këtë mënyrë ju krijoni një bazë solide edhe për mësimin e gjuhës së dytë.

Verwöhnen Sie Ihr Kind von Anfang an mit Ihrer eigenen Sprache. Indem Sie seine Sprechfreude wecken und ihm ein gutes sprachliches Vorbild bieten, unterstützen Sie seine sprachliche Entwicklung in seiner Muttersprache. Damit schaffen Sie gleichzeitig auch eine wichtige Basis für das erfolgreiche Lernen der zweiten Sprache.

4 I ofroni fëmijës mundësi për përdorimin e hershëm dhe të shpeshtë të gjuhës së dytë.

Gjuha e dytë mësohet më lehtë në "situatat e përditshme", në sheshin e lojërave, me miqtë dhe mikeshat në shtëpi, në çerden e fëmijëve etj.

Geben Sie Ihrem Kind früh und häufig Gelegenheit, seine Zweitsprache zu erleben und auch anzuwenden. Unter „alltäglichen Bedingungen“ lernt sich die Zweitsprache leichter – auf dem Spielplatz, mit Freunden und Freundinnen zu Hause, in der Kindertageseinrichtung.

5 Nëse fëmija nuk flet gjermanisht kur fillon të shkojë në kopshtin e fëmijëve, vazhdoni të flisni me të në gjuhën tuaj amtare.

Në këtë mënyrë do ta mbështetni që të përvetësojë gjuhën e parë. Njëkohësisht, ju duhet t'i ofroni mundësi që të flasë shpesh gjermanisht me fëmijët e tjerë jashtë kopshtit të fëmijëve. Në këtë mënyrë ai do të mësojë mirë gjuhën gjermane.

Wenn Ihr Kind beim Eintritt in die Kindertageseinrichtung noch nicht Deutsch spricht, sprechen Sie auch weiterhin mit ihm in Ihrer Muttersprache. Damit unterstützen Sie Ihr Kind, den Spracherwerb in seiner ersten Sprache abzuschließen. Geben Sie Ihrem Kind gleichzeitig ausreichend Gelegenheit, auch außerhalb der Kita mit deutschsprachigen Kindern zu spielen, damit es gut Deutsch lernen kann.

Për më shumë informacion vizitoni faqen web

→ www.kindergesundheit-info.de

Weitere Informationen unter

→ www.kindergesundheit-info.de



Kurz. Knapp.
Eltern-Info

Babys + Kleinkinder 0-3 Jahre

Formular Impressum

Lëshues Herausgeber Stadt Ulm, Fachbereich Bildung und Soziales

Menaxhimi i projektit Projektleitung Elisabeth Sailer-Glaser

Dizajn Gestaltung zambrino unternehmergesellschaft, www.zambrino.eu

Botim Auflage 200

Gjendja Stand April 2013

BZgA

Bundeszentrale
für
gesundheitliche
Aufklärung

Wir bedanken uns bei der BZgA für die Überlassung der Nutzungsrechte und die Genehmigung zur Übersetzung und Produktion für diese Publikation.